VENDIMI
Nr.9, datë 18.5.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli, Anëtar i " "
Zija Vuci, Anëtar i " "
Hajredin Fuga, Anëtar i " "
Kristofor Peçi, Anëtar i " "
Kujtim Puto, Anëtar i " "
Sokol Sadushi, Anëtar i " "
Alfred Karamuço, Anëtar i " "

me sekretare Drita Filto më datë 6.5.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13 Akti që i përket:

KËRKUES: SHEFQET BRUKA, Kryetar i Këshillit të Rrethit Kukës.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave i përfaqësuar nga zotërinjtë. Shahin Bistri Zyher Beci, me autorizim.

OBJEKTI:

Shfuqizimin e Vendimit nr.19, datë 5.1.1998 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e të deleguarit të Këshillit të Ministrave në funksionin e Kryetarit të Komunës Bushtricë të rrethit të Kukësit".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në datën 23.11.1997 ka vdekur kryetari i komunës së Bushtricës në rrethin e Kukësit, Maksut Palushi.

Me propozim të ish-Sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.19, datë 05.01.1998 ka caktuar si të deleguar me detyrën e kryetarit të komunës, deri në zhvillimin e zgjedhjeve të reja për këtë funksion zotin Ramadan Gjici.

Zoti Shefqet Bruka, me detyrën e Kryetarit të Këshillit të Rrethit të Kukësit, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka pretenduar se Vendimi nr.19, datë 05.01.1998 i Këshillit të Ministrave, është i pabazuar në ligj e si i tillë duhet të shfuqizohet. Për këtë kërkesë Z.Shefqet Bruka sjell si argument faktin se Këshilli i Ministrave në bazë të Ligjit nr.8068, datë 05.02.1996 mund të caktojë të deleguar në rastet e shkarkimit të kryetarëve të komunave e bashkive e jo në raste të tjera (siç është edhe vdekja) dhe se detyrat e kryetarit përkohësisht mund t'i kryejë zëvëndëskryetari i komunës. Sipas tij, në këtë mënyrë janë shkelur pavarësia e vetëadministrimi i pushtetit lokal.

Gjykata Kushtetuese, pa i hyrë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit, konstaton para së gjithash se ai nuk legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Sipas nenit 25 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992, krahas subjekteve të tjerë, Gjykatën Kushtetuese e venë në lëvizje me kërkesën e tyre edhe organet lokale të pushtetit. Por, kryetari i këshillit të rrethit (siç është në këtë rast kërkuesi) nuk është organ përfaqësues pushteti. Në bazë të nenit 7 të Ligjit Kushtetues nr.7570, datë 03.06.1992 si kryetari ashtu dhe kryesia e këshillit të rrethit, janë organe ekzekutive. Si të tilla funksionet e tyre janë të përcaktuara në Ligjin nr.7572, datë 10.06.1992 "Për Organizimin e Funksionimin e Pushtetit Lokal" nga neni 52 i të cilit del se ata nuk mund të përfaqësojnë në raport me organet e tjera këshillin e rrethit pa u ngarkuar shprehimisht nga ai. Ndryshe ndodh me subjektet e tjera që janë të zgjedhur direkt nga populli e që ligji kushtetues i konsideron organe përfaqësuese pushteti, siç janë kryetari i komunës apo i bashkisë. Për këto organe, Ligji nr.7572, datë 10.06.1992

(neni 33) parashikon shprehimisht të drejtën e tyre të përfaqësimit.

Gjithashtu, kërkuesi nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese edhe në emër të Këshillit të Rrethit të Kukësit, pasi, ashtu siç doli nga shqyrtimi i çështjes, këshilli i rrethit jo vetëm nuk e ka autorizuar atë për një veprim të tillë, por as që e ka diskutuar këtë problem.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
Tiranë, më 18.5.1998

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër shumicës për këto arsye:

Sipas nenit 52/2 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal" Kryetari i Këshillit të Rrethit, drejton administratën publike të rrethit dhe përgjigjet për funksionimin e mirë të saj. Sipas nenit 33, në kombinim me nenin 554 të këtij ligji , kryetari e përfaqëson rrethin në organet shtetërore siç ka vepruar kryetari z. Shefqet Bruka në rastin konkret.

Për pasojë kërkesa e tij drejtuar kësaj gjykate dhe ai vetë duhej të njiheshin të legjitimuar.

Anëtari
Hilmi Dakli